

Këancës



Ministria e Kultures, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Optina Klinë

DRAFT

Plani Lokal i Veprimit për Rini

2015 - 2016

LAW NO. 000983/R/2015 FOR LOCAL PLANNING			
MUNICIPALITY OF KLINË			
Planned by:			
Signature of: Gjergj Krasniqi Planned by:			
Date: 01.02.2015	Signature: Gjergj Krasniqi	Signature: Anil Luka Puci	Signature: Rustemi Veliu
01 082-1692115			

Klinë, Shkurt 2015



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kultures, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Opština Klinë



Fig. I.1 - Harta e Komunës së Klinës më të gjitha vendbanimet

Plani Lokal i Veprimit Rinor 2015-2016 si dokumenti më i rëndësishëm për rini e Klinës është punuar me përkushtim dhe kujdes nga Organizata Joqeveritare KOHA dhe me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Angazhimi i OJQ KOHA-së ka ardhur si rekonditiv i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Klinës për shkak të mungesës së zyrtarit Komunal për rini dhe kapacitetave brenda Drejtorisë. Punimi i këtij plani është bërë në bashkëpunim të plotë më DKRS-në duke u përshtatur me mundësitë e politikave publike Komunale dhe duke u diskutuar hollësisht me aktorë në lëmi të ndryshme si në nivel lokal po ashtu në atë nacional.

Të dashur të rinj të komunës së Klinës,

Miratimi i strategjisë së Planit Lokal të Veprimit Rinor 2015-2016 është një hap tejet domethënës në angazhimet tona të përbashkëta për fuqizimin e rinisë në jetën publike. Ky plan në vete përmban prioritetet, objektivat dhe propozimet dhe në përputhje me domenin e fushëveprimit të institucioneve publike që veprojnë në komunën e Klinës do te synojë përbashjen e këtyre prioriteteve dhe objektivave pararendëse me qëllim të realizimit sa më efikas të interesave të rinisë së kësaj komune.

Rinia është një prioritet nacional, në rastin tonë një prioritet lokal, për shumë arsyë e në radhe të parë për pasionin e madh që kjo rini ka treguar në vazhdimësi për kulturë dhe edukim dhe për kontributin e vlefshëm të dhënë përgjatë gjithë hapave të zhvillimit të komunës sonë. Kjo mbështetja do të vazhdojë të rritet edhe në të ardhmen falë synimeve dhe iniciativave të vazhdueshme të rinisë të adresuara pranë institucioneve publike. Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe buxheti i Komunës së Klinës, këto iniciativa të përbashkëta do të jetësohen në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar si BE-se, Këshilli Evropian, OSBE si dhe nga OJQ te ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përmes të cilave mëtohet të arrihet përkrahje për idetë dhe projekte të qëlluara të shumë të rinjve dhe organizatave rinore.

Plani i Veprimit Lokal do të avancoj edhe më shumë përkrahjen për grupet rinore ku përveç Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, do të përfshihen edhe institucione të tjera në nivelin lokal dhe qendror të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e politikave rinore dhe do të fuqizojnë në vazhdimësi rolin e rinisë. Ky dokument mund të mos adresojë të gjitha kërkuesat që mund të ketë secili i ri në Komunën e Klinës, megjithatë është një dokument i përgatitur në bazë të veçorive socio-ekonomike të pranishme në territorin e komunës, dhe se i njëjtë mund të zbatohet në praktikë përmes bashkëpunimit të të gjithë neve. Ftojmë secilin që, duke lënë anash dallimet çfarëdo qofshin ato, të punojë për avancimin dhe fuqizimin e të rinjve të komunës sonë, që pa dyshim janë jo vetëm e tashmja, por edhe e ardhmja e vendit.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mbështetje edhe të Kryetarit të Komunës së Klinës, z.Sokol Bashota, do të jetë përherë partneri kryesor në angazhimet dhe iniciativat të cilat na ofrohen nga të rinjtë për arritjen qëllimeve të përbashkëta, duke mos anashkaluar asnjë plan, ide apo iniciative rinore qe burojnë pikërisht nga ju.

Sinqerisht,
Kristina Lazri
 Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport



PËRMBAJTJA

1. TERMINOLOGJIA	6
2. BAZA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RINI (PLVR).....	7
3. HYRJE.....	8
4. MISIONI.....	8
5. QËLLIMI.....	8
6. METODOLOGJIA.....	9
7. PROCESI I HARTIMIT TË PLVR-së 2015-2016.....	11
8. ANALIZË E SITUATËS.....	12
9. SWOT ANALIZA.....	13
10. PLVR-ja.....	14
11. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTESET PLVR-ja.....	15
11.1 Parimi i ligjshmërisë.....	15
11.2 Parimi i pjesëmarrjes.....	15
11.3 Parimi i trajtimit të barabartë.....	15
11.4 Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësive.....	16
11.5 Parimi për të drejtën e informimit.....	16
11.6 Parimi i hartimit të planit të bazuar në dëshmi.....	16
11.7 Parimi i qëndrueshmërisë.....	16
12. KËSHILLI I VEPRIMIT RINOR LOKAL (KVRL).....	16
12.1 Detyrat kryesore të KVRL-së.....	17
12.2 Përfaqësimi dhe funksionimi i brendshëm demokratik i KVRL-së.....	17
12.3 Procedurat për regjistrimin dhe njohjen e KVRL-së, si dhe raportimi i KVRL-së.....	17
12.4 Mbështetja financiare.....	18
13. QENDRA RINORE.....	18
13.1 E drejta për licencim.....	19
13.2 Kërkesa për licencim, mënyra dhe kushtet.....	19
13.3 Komisioni dhe shqyrtimi i kërkesës.....	19
13.4 Vendimi për licencim.....	20
13.5 Refuzimi i licencimit, e drejta për ankesë.....	20
14. FUSHAT STRATEGJIKE TË PLVR-së.....	21



14.1 Pjesëmarrja e rinisë dhe përfaqësimi i saj në institucionet publike.....	21
14.1.1 Objektivi strategjik i pjesëmarrjes së rinisë dhe përfaqësimit të saj në institucionet publike.....	22
14.2 Edukim jo-formal i të rinjve.....	22
14.2.1 Objektivi strategjik i edukimit jo-formal.....	23
14.3 Punësimi dhe ndërmarrësi.....	23
14.3.1 Objektivi strategjik për punësim dhe ndërmarrësi.....	24
14.4 Shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor.....	24
14.4.1 Objektivi strategjik i shëndetit, edukimit dhe promovimit shëndetësor.....	25
14.5 Siguria njerëzore.....	26
14.5.1 Objektivi strategjik i sigurisë njerëzore.....	26
14.6 Sporti, kultura, rekreacioni dhe vullnetarizmi.....	27
14.6.1 Objektivi strategjik i sportit, kulturës, rekreacionit dhe vullnetarizmit.....	28
15. AKTIVITETET E PARAPARA PËR VITIN 2015-2016	28
16. TABELA E AKTIVITETEVE PËR VITET 2015-2016	30



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Opština Klinë

I. TERMINOLOGJA

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport – MKRS
 Departamenti i Rinisë – DiR
 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – DKRS/Drejtoria për Rini
 Plani Lokal i Veprimit për Rini – PLVR
 Organizata Joqeveritare – OJQ
 Këshilli i Veprimit Rinor Lokal – KVRL
 Qendër Rinore – QR
 Komuna e Klinës – KK Klinë
 Shoqëria Civile – SHC
 Udhëzim Administrativ – UA
 Këshilli Qendror i Veprimit Rinor – KQVR
 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS
 Drejtoria Komunale për Arsim – DKA
 Drejtoria e Urbanizmit dhe e Ruajtja e Mjedisit - DURM

2. BAZA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RINI (PLVR) 2015-2016

Më qëllim të përmirësimit të situatës, kushteve dhe fuqizimin e të rinjve, krijimit të mundësive të barabarta për zhvillim dhe zbatimit të Ligjit 03-L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë; Strategjisë Kosovare për Rini 2013-2017; Udhëzimin Administrativ nr. 9-2010 për Përgjegjësitë dhe Procedurat e Themelimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë; Udhëzimin Administrativ Nr. 11 për Regjistrimin e Qendrave Rinore, aktet nënligjore, dokumentet strategjike relevante të Qeverisë së Kosovës dhe Komunës së Klinës, parimeve universale për të drejtat e të rinjve, praktikave të mira në vende të ndryshme dhe nevojës së madhe që Komuna e Klinës dhe të rinjtë e Klinës, pas një kohe të gjatë, të kenë planin e tyre të veprimit për rini, i cili do të jetë në shërbim të dyanshëm në dy vitet e ardhshme, Komunës së Klinës në njëren anë dhe të rinjve të grupmoshave prej 15 deri 24 vjeç në anën tjetër.

PLVR do të ketë për bazë politikat e Ministrisë për Kulturë, Rini e Sport dhe politikat, përgjegjësitë e mundësítë komunale, duke inkorporuar nevojat e sotme të rinisë së Komunës së Klinës. Po ashtu, do ta ketë për bazë edhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2011 – 2014, i cili është diskutuar ndërmjet aktorëve rinor lokal, por nuk është sjellë dhe miratuar në Kuvendin e Komunës.



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kultures, Rinise dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Opština Klinë

3. HYRJE

Plani Lokal i Veprimit për Rini 2015-2016 (tutje PLVR) paraqet bazën kryesore të funksionimit të Sektorit për Rini në Komunën e Klinës. PLVR është dokumenti kryesor për rini, i shumë munguar deri me tanë, i cili do të shërbejë në orientimin e politikave lokale rinore, duke përfshirë një analizë të sektorit të rinisë në Komunën e Klinës, qëllimin, objektivat dhe aktivitetet.

PLVR është dokument zyrtar strategjik i Komunës së Klinës i punuar me përkushtim të madh dhe serioz nga OJQ KOHA dhe i diskutuar në mënyrë të thuktë dhe të hapur nga aktorët lokal institucional, qeveritar dhe jo qeveritar.

Ky plan është i bazuar në Ligj dhe UA dhe është në përputhje të plotë me prioritetet e qeverisjes lokale, sektorit për rini, dhe synon angazhimin e rinisë, krijimin e kushteve për një jetë më të mirë përmes angazhimit të të gjithë aktorëve lokal rinor, OJQ-të, QR, KVRL, dhe grupe të tjera formale apo jo formale në këtë sektor që krijojnë mundësinë e mbrojtjes dhe fuqizimit të rinisë në Komunën e Klinës. Miratimi dhe zbatimi i këtij Plani bënë hapin e parë në trajtimin e rregullt dhe në mënyrë të drejtë të rinisë, krijon mundësi për përfaqësim dhe pjesëmarrje, si edhe të jetë përfitues nga mundësitë e krijuara.

4. MISIONI

PLVR ka mision përkrahjen e të rinjve për të bërë realitet vizionin e tyre, duke mundësuar edukim sa më të mirë, rini të informuar mbi të drejtat e përgjegjësitet dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarje. Mbrojtja e shëndetit dhe krijimi i sigurisë, edukimi jo-formal dhe krijimi i lehtësirave për qasje në tregun e punës, si edhe përkrahja e atyre që përballen me fenomene negative në shoqëri e angazhimi rinor në aktivitete të ndryshme janë synimet tjera të këtij Plani.

5. QËLLIMI

PLVR ka qëllim krijimin e një baze për trajtim të rregullt dhe në mënyrë të drejtë të sektorit të rinisë nga ana e organeve komunale dhe në këtë mënyrë të krijoj mundësinë e angazhimit aktiv të rinisë në çështjet sektoriale rinore, krijim të kushteve për zhvillim të rinisë duke përmirësuar mundësitë për zhvillime të aktiviteteve të ndryshme, edukim dhe siguri, pjesëmarrje dhe informim, ngritje profesionale dhe mundësi për aktivitete kulturore, sportive dhe rekreative.

Qëllim tjetër do të jetë edhe krijimi i një baze për një bashkëpunim të secilit aktorë lokal rinor që duke shfrytëzuar resurset aktuale dhe ato të reja të krijojnë mundësi për realizimin e shumë aktiviteteve e iniciativave lokale në të mirë të zhvillimit të rinisë dhe Komunës së Klinës.

6. METODOLOGJIA

6.1 Plani i Veprimit për Rini në Komunën e Klinës (PLVR), është punuar nga Organizata Joqeveritare "KOHA" me seli në Klinë. Miratimit të këtij Plani i ka paraprirë një diskutim i gjërë ndërmjet të gjithë aktorëve lokal duke nisur nga bashkëpunimi dhe kontributi direkt i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, zyra e Kryetarit, si edhe kontributi financiar dhe konsultimi me Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Departamenti për Rini.

6.1.1 PLVR-ja është hartuar në harmoni të plotë më Strategjinë Nacionale për Rini, por duke i përshtatur nevojave, specifikave dhe mundësive në Komunën e Klinës.

6.1.2 PLVR-ja ka pasur përfshirje të gjerë që nga dita e parë e punës në këtë dokument. Aktorët lokal rino, nisur nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, OJQ "Ardhmëria" (funkSIONALE si Qendër Rinore në Klinë), Këshillat e shkollave të mesme dhe fillore në Komunën e Klinës nga Shkolla e Mesme "Luigj Gurakuqi" dhe Shkolla e Mesme Profesionale "Fehmi Agani", përkatësisht shkolla e mesme e ulët "Ismet Raci", si dhe Qendra në Zllakuqan (funkSIONALE si Qendër Rinore në këtë fshat).

6.1.3 Në mungesë të të dhënave për rinin në Komunën e Klinës, mungesë e grupeve të organizuara në fshatra dhe me qëllim përfshirjen e sa më shumë të rinjve është realizuar një hulumtim përmes një pyetësori mbi gjendjen dhe nevojat e të rinjve në Komunën e Klinës me përfshirje të 337 nxënësve të moshës mbi 15 vjeçare nga shkollat e mesme dhe fillore të Komunës së Klinës, duke përfshirë edhe zonat rurale, si: 1. Shkolla e Mesme "Luigj Gurakuqi"; 2. Shkolla e Mesme Profesionale "Fehmi Agani në Klinë"; 3. Klasë të 9-ta në Ujëmirë; 4. Klasë të 9-ta në Çabiq; 5. Klasë të 9-ta në Gllarevë; 6. Klasë të 9-ta në Sferkë; Klasë të 9-ta në Drenoc; 10. Klasë të 9-ta në Potërq; 10. Klasë të 9-ta në Budisalc;

6.1.4 Takimeve dhe punëtorive me Organizatat Joqeveritare aktive në Komunën e Klinës: OJQ KOHA (si hartuese e Planit), Shoqata e Gruas "Elena Gjika", OJQ "Adhmëria", Shoqata e Gruas "Zana", Shoqata "Indira" në Jagodë, Shoqata "Youth Steps for Change", si dhe është konsultuar edhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evrope (OSCE), ekipi per qeverisje lokale ne Klinë;

6.1.5 Me qëllim edhe për informacione me të gjëra nga fusha të ndryshme janë realizuar takime dhe janë bërë kërkesa zyrtare për të marrë informacione mbi të rinjtë e grup moshave prej 15 deri në 24 vjeç edhe nga Qendra për Punë Sociale, Policia në Klinë, Qendra e punësimit dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;

6.1.6 Gjatë hartimit të këtij Plani janë konsultuar edhe dokumente të tjera, hulumtime dhe



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Optina Klinë

gjetje që prekin çështjen e të rinjve në Klinë dhe Kosovë (meqë Klinë nuk bënë përjashtim nga zhvillimet në nivel vendi);

6.1.7 Me qëllim të një përfshirje reale të të gjithë aktorëve (takimet, hulumtimet, diskutimet), janë bërë në fazën fillore të hartimit të PLVR-së. Gjetjet dhe konsultimet e shumta janë përfshirë në Planin Lokal të Veprimit për Rini, i cili i është dorëzuar DKRS-së, MKRS-së, përkatësisht Departamentit për Rini;

6.1.8 PLVR 2015-2016, diskutimi i tij ka përfshirë zonat urbane dhe zonat rurale në Komunën e Klinës duke përfshirë edhe minoritetet.

7. PROCESI I HARTIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT RINOR 2015-2016

Takimet	Diskutimet	Zhvillimi	Prezantimi	Miratimi Kuvendin Komunal në Klinë
Aktorët Komunal: DKRS; Zyra e Kryetarit;	Përfshirje e hapur dhe e gjërt e të gjithe aktoreve lokale rinor dhe të tjerë; KVRL; OJQ-të lokale (Ardhmëria, Elena Gjika, Zana, Indira, Youth Steps for Change; Këshillat e mxenësve të dy shkollave të mesme; Anketim me të rinj mbi njoftimit, glendjen dhe nevojat e të rinjve ne shkolla, zona urbane dhe rurale; Të rinjtë e subjekteve politike në Komunën e Klinës.	Pranimi i informacioneve për të rinjt nga Qendra për Punë Sociale, Zyra e Punësimit, Policia në Klinë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Klinë, Grumbullimi i të gjitha gjetjeve dhe informacioneve të pranuara nga aktivitetet e mëhershme.	Prezantimi Draftit në MKRS, Departamenti për Rini; DKRS	Diskutimi brenda KK-së dhe më gjëre; Procedimi miratimi Kuvendin Komunal
Nëntor-Dhjetor- Janar-Shkurt	Dhjetor-Janar	Janar-Shkurt	Shkurt	Shkurt-Mars



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinise dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klina-Optina Klina

8. ANALIZA E SITUATËS

Komuna e Klinës, nuk bënë përjashtim nga situata në të cilën gjendet vendi. Andaj, problemet dhe sfidat në nivel nacional reflektojnë trajtimin dhe zhvillimin e Komunës së Klinës me të gjitha fushat që krijojnë një vend të zhvilluar, kushte dhe barazi për të gjitha shtresat shoqërore. Klina, po ashtu nuk bënë përjashtim nga numri i të rindjeve i cili është edhe në nivel nacional. Për shkak të shumë arsyeve, duke nisur nga gjendja e rënd socio-ekonomike, buxhetit të ulët, problemeve të shumta në terren dhe nevoja për investime tejet elementare, të rindjtë, si grupi më i madh në shoqëri nuk kanë pasur mjaftueshmë vëmendjen e organeve lokale dhe si pasojë kemi një rini tejet pasive dhe me kushte jo të favorshme për zhvillim kulturor, social, ekonomik e profesional apo sportiv.

Komuna e Klinës, nga paslufta ka mungesë të Planeve Veprimi Për Rini, që do të ishin udhë-rëfyes për aktivitetet dhe orientimet e politikave rinore në vazhdimësi. Si pasojë e kësaj, shumë zhvillime për rini kanë qenë *ad hoc* apo me inicim nga niveli nacional (dita apo java e rinisë), ose nga Organizata Joqeveritare lokale dhe me pak si iniciativë e Komunës së Klinës, përkatësisht e Departamentit përkatës. Komuna e Klinës ka mungesë të bashkëpunimit ndërmjet OJQ-ve dhe organeve komunale, Qendra Rinore është ende e pa licencuar, KVRL me probleme dhe më mos përfshirje të të gjitha OJQ-ve aktive lokale, rinia në fshatra pa asnjë organizim dhe mundësi, dhe në këtë mënyrë edhe mungesë e madhe e informacioneve dhe përfshirjes rinore në politikat sektoriale rinore, po ashtu edhe mungesë e infrastrukturës.

Ndihet një mungesë e madhe e informacioneve mbi gjendjen e të rindjeve në Komunën e Klinës. Bërrja e secilit plan veprimi obligon të ketë një bazë nga hulumtime të mëparshme apo efektit të planeve të mëparshme, por të cilat nuk ekzistojnë dhe hartimin e PLVR-së e bënë me sfidues. Për këtë arsyë është realizuar hulumtimi nga OJQ KOHA (krahas diskutimeve me të gjithë aktorët lokal), vetëm për të pasur një gjendje nga vetë të rindjtë e që mund të jetë një kontribut që do të vë hapat e parë dhe të domosdoshëm në trajtimin e rinisë së Klinës. Është vërejtur një pasivitet i KVRL-së dhe e disa OJQ-ve dhe kontributi i tyre ka qenë minimal në draftimin e PLVR-së, edhe pse puna e tyre lidhet direkt me rinin.

Disa nga të dhënat janë shqetësuese, sidomos kur janë 73.59% e të intervistuarve që thonë që nuk kanë njojuri rrëth Ligjit për Rini, e që është bazë për secilin dokument tjetër për rinin dhe funksionimin e saj. Po ashtu, njojuritë rrëth ekzistencës së KVRL-së dhe QR-së janë tejet të vogla, 64.99% thonë që nuk kanë njojuri për punën e këtyre mekanizmave që mbrojnë dhe avokojnë për rinin, përkatësisht edukojnë dhe angazhojnë të rindjtë në aktivitete të ndryshme. Po ashtu në pyetjen për planifikimet që kanë të rindjtë pas shkollës së mesme, vërehet që mbi 33% shprehen që dëshirojnë jetën jashtë Kosovës, shkollimi i mëtejmë është më përqindje të madhe, mbi 82%, ndërsa mbi 31% kërkojnë punë. Andaj, pasqyrimi i këtyre të gjeturave do të shërbuje që adresimi i gjendjes dhe i prioriteteve të rinisë të bëhet sa më i saktë e jo në adresime e akuza të ndryshme, por që të marr dorën dhe përgjegjësinë e organeve komunale që hap pas hapi ta vë rinen si



prioritet dhe dy vitet e zbatimit të këtij Plani rininë ta gjejë në një nivel tjetër të mundësive.

9. SWOT ANALIZA

Përparrësitë	Dobësitë	Mundësítë	Rrezigjet
<p>Infrastruktura Ligjore Nacionale;</p> <p>Infrastruktura nacionale;</p> <p>Rreth 40% moshë rinore;</p> <p>Të rinj të shkolluar dhe njohje e gjuhëve të huaja;</p> <p>Bashkëpunimi me MKRS, Departamenti për Rini;</p> <p>Grante vjetore për rini nga Departamenti për Rini;</p> <p>Vullneti për ndryshime pozitive.</p>	<p>Mungesë e Planeve lokale për rini;</p> <p>Kapacitetet institucionale;</p> <p>Staf i kualifikuar menaxhues;</p> <p>Bashkëpunimi me Organizata Rinore dhe organizata të tjera;</p> <p>KVRL lokale pa përfshirje të gjerë dhe jo aktive;</p> <p>Qendra Rinore e pa licencuar;</p> <p>Infrastruktura Komunale;</p> <p>Stimulim i ulët i të rinjve për biznes dhe përkrahja e talenteve të rinj;</p> <p>Njohje e ulët me tregun e punës;</p> <p>Vendimmarrja e të rinjve në nivel lokal;</p> <p>Njohja e punës vullnetare;</p> <p>Bashkëpunimi ndër-sektorial;</p> <p>Sigurimet shëndetësore;</p> <p>Mungesa e të dhënave për të rinj nga institucionet dhe mos trajtimi i të dhënave, si: QKMF, QPS, Policia apo Qendra për Punësim.</p>	<p>Hapësirë e bollshme, pronë e Komunës;</p> <p>Ndërtimi i infrastrukturës për të rinj;</p> <p>Avancim i infrastrukturës ligjore;</p> <p>Funksionalizimi i mirëfilltë i KVRL-së;</p> <p>Licencim i Qendrës Rinore;</p> <p>Stimulim i të rinjve për biznes;</p> <p>Komunikimi me donatorë dhe aktorë tjerë publik dhe privat;</p> <p>Bashkëpunimi me OJQ-të;</p> <p>Informimi dhe nxitja për punë vullnetare;</p> <p>Organizimi i edukimit jo-formal;</p> <p>Kategorizimi i të dhënave për grup-moshat 15 deri 24 vjeçare.</p>	<p>Zhvillimi ekonomik lokal dhe nacional;</p> <p>Buxheti i ulët i DKRS-së, sektori i rinisë;</p> <p>Papunësia në nivel të lartë;</p> <p>Rinia dëshiron largimin nga vendi.</p>



10. PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL

10.1 Plani i Veprimit Rinor Lokal 2015-2016 për Komunën e Klinës vjen si rezultat i nevojës së Komunës dhe të rinjve për të pasur një udhë-rrëfyes në zhvillimin e politikave rinore lokale drejt një rinie të shëndosh dhe me prosperitet, rini e edukuar mirë dhe me mundësi adekuate zhvillimi duke synuar një rini aktive e të barabartë më të rinjtë tjerë në rajon dhe Evropë.

10.2 PLVR është dokument i bazuar në Ligjet e zbatueshme në Republikën e Kosovës, Udhëzimeve Administrative dhe dokumenteve të tjera nationale e lokale.

10.3 PLVR është hartuar në harmoni më Strategjinë Nacionale për Rini dhe nevojat e qëllimet e rinisë së Klinës.

10.4 PLVR është dokument që vjen si rezultat i mungesës së Planeve Rinore në Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini e Sport dhe mos-pasjes së PLVR-së dhe dokumenteve të tjera për rini të miratuar në Kuvend.

10.5 Ky Plan është në shërbim të plotë të DKRS-së dhe rinisë në përgjithësi.

10.6 PLVR do të jetë në gjendje që të inicioj trajtimin e rinisë duke qenë plan funksional në gjithë territorin e Komunës së Klinës. Plani synon identifikimin dhe adresimin e çështjeve me rëndësi për rinin e Klinës të grup moshës 15-24 vjeç, si edhe përfshirje të gjerë të aktorëve publik e privat, qeveritar dhe jo qeveritar me qëllim përmirësimin e gjendjes së rinisë dhe realizimin e objektivave.

10.7 PLVR është dokument strategjik që në përbajtjen e tij përfshin interesat vitale dhe nevojat e të rinjve të Klinës për periudhën kohore 2015 – 2016.

10.8 Duke pasur parasysh nevojat e mëtejme dhe realizimin e kërkesave të të rinjve, dhe paraqitjen e kërkesave në rrethana të reja lidhur me zhvillimet e sotme rinore në Komunën e Klinës, por edhe përfundimin e përbillyjes së suksesshme të PLVR-së 2015 – 2016, si dhe objektivat e përbushura, ndihet një nevojë e theksuar për të vazhduar rrugën e avancimeve në vazhdimin e politikave rinore, për përcaktimin e objektivave të reja strategjike dhe hartimin e planit të ri të veprimit.

10.9 PLVR është dokument që do të adresoj këto çështje:

10.10.1 Pjesëmarrje të rinisë - Rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe përfshirja sa më e madhe e të rinjve në politikë-bërje sektoriale që ndikojnë drejtpërdrejt në të rinjtë;

10.10.2 Edukimi jo-formal - Të rinj të edukuar dhe të përgatitur për të përballuar të gjitha sfidat e jetës si anëtarë të përgjegjshëm të komunitetit vendor dhe evropian;

10.10.3 Punësimi dhe ndërmarrësia - Nxitjen e punësimit përmes trajnimeve dhe mbështetjes së ndërmarrësve të rinj;

10.10.4 Shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor - Të rinj të vetëdijesuar lidhur me rëndësinë e ruajtjes së shëndetit për mirëqenien e tyre individuale dhe shoqërore, si dhe për kontributin e tyre si qytetar të përgjegjshëm të vendit;

10.10.5 Siguria njerëzore - Të rijnë të përgatitur për të identifikuar, parandaluar dhe adresuar me kohë në mënyrë efektive rrezikun që u kanoset të rinjve;

10.10.6 Sporti, kultura dhe rekreacioni - Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore, ekonomike dhe kulturore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive.

11. PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET PLVR-ja

11.1 Parimet e PLVR-së, nënkuptojnë respektimin e të gjithë të rinjve dhe të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë në të gjitha sferat shoqërore, ekonomike, arsimore, fetare dhe kulturore me qëllim të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve pa dallime etnike në të gjitha aktivitetet komunale në përputhje me parimet dhe vlerat evropiane për të drejtat e njeriut.

11.2 Sikur Strategjia dhe Plani i veprimit Nacional për rini, edhe PLVR mbështetet mbi këto parime:

11.2.1 Parimi i ligjshmërisë - Plani Lokal i Veprimit për Rininë mbështeten në Ligjin për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të rinisë, aktet nënligjore, dokumentet strategjike relevante të Qeverisë së Kosovës dhe Komunës së Klinës dhe në parimet universale për të drejtat e të rinjve.

11.2.2 Parimi i pjesëmarrjes - Hartimi i PLVR-së, është realizuar përmes një sistemi të gjerë pjesëmarrjeje, që përfshinë institucionet lokale, shoqërinë civile, organizatat jo-qeveritare rimore dhe të tjera, Këshillin e Veprimit Rinor Lokal, këshilla të shkollave dhe akterë tjerë që veprojnë në Komunë. Pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesuara, diskutimi i thuktë dhe në çdo fazë përbën edhe një tipar dallues të këtij Plani.

11.2.3 Parimi i trajtimit të barabartë - Përfshinë mbështetjen e të rinjve pa marrë parasysh etninë, gjininë, përkatësinë sociale dhe duke respektuar në veçanti përkrahjen e të rinjve me nevoja të veçanta dhe të rinjve të marginalizuara.

11.2.4 Parimi i qasjes së përbashkët, ndarjes së përvojave dhe përgjegjësive - Çështjet që i preokupojnë të rinjtë janë çështje ndër-sektoriale që janë para së gjithash përgjegjësi dhe obligim i ministrive të linjës dhe qeverisjes lokale, Drejtorisë për rini prandaj është i domosdoshëm shkëmbimi i informatave, përvojave dhe resurseve me qëllim të përbushjes së objektivave të parapara në këtë dokument strategjik.

11.2.5 Parimi për të drejtën e informimit - Parimi i të drejtës së informimit nënkuption të drejtën për informim të të rinjve si dhe qasjen në informacione në të gjitha sferat e interesit të tyre institucional.

11.2.6 Parimi i hartimit të planit bazuar në dëshmi - Çështjet rinore ndryshojnë vazhdimesht, varësisht nga trendi aktual dhe nevojat e të rinjve. PLVR synon të mbështes zbatimin e objektivave të parapara dhe të përkrahë hulumtimet e vazhdueshme që identifikojnë nevojat e të rinjve dhe mundësojnë zhvillimin e politikave rinore të mbështetura në të dhëna konkrete.

11.2.7 Parimi i qëndrueshmërisë - PLVR është konceptuar si një platformë synimesh që nxit një pjesëmarrje aktive të grupeve të interesuara në zbatimin e saj. DKRS, sektori për rini, si përgjegjës kryesor në bashkëpunim me partnerët do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Planit.

12. KËSHILLI I VEPRIMIT RINOR LOKAL

12.1 Sipas Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) është formacion këshillues i organizatave rinoare, që veprojnë në nivel lokal dhe përfaqësojnë interesant e organizatave rinoare dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal.

12.2 Përgjegjësitë e punës së KVRL-së bazohen në parimin e barazisë dhe të pjesëmarrjes së barabartë për të gjithë, kurse rregullohen me akte nënligjore.

12.3 Sipas udhëzimit Administrativ mbi përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të KVRL-ve në Kosovë, KVRL-të kanë këto përgjegjësi:

12.4 Të fuqizoj organizatat rinoare të komunës ku ato veprojnë për të ndërtuar një vizion të përbashkët për të rinjtë dhe të ndërmarrë veprime gjegjëse si dhe të përgatisë planin e veprimit për të arritur një vizion të tillë.

12.5 Të promovoj vizionin e specifikuar tek institucionet e pushtetit lokal dhe organizatave tjera që adresojnë çështje të rinisë në Komunë, si edhe të promovoj, koordinoj dhe shkëmbej përvojat e mira me organizata tjera rinoare si edhe të bashkëpunoj



lidhur më çeshtjet që prekin interesat e rinisë me institucione të tjera publike dhe private, vendore dhe ndërkombëtare.

12.1.1 Detyrat kryesore të KVRL-së

12.1.1.1 Të përfaqësoj organizatat rimore të Komunës para institucioneve gjegjëse dhe të

adresoj çeshtjet e të rinxve të Komunës para institucioneve komunale dhe para personave të tjerë publik i privat, por edhe në takimet më KQVR-në.

12.1.1.2 T'ju ofrojë mendime e këshilla organeve dhe institucioneve komunale për veprimet që duhet ndërmarrë, të parades qëndrime për dokumentet ligjore dhe dokumente të tjera sa u përket çeshtjeve të të rinxve në Komunë, si edhe të marrë pjesë aktive në hartimin, zbatimin, vlerësimin dhe drejtimin e politikave rimore.

12.1.1.3 Të jetë në shërbim të rinisë, të marrë pjesë dhe kontribuoj në hartimin e propozim buxhetit vjetor për rini dhe të bëjë planifikimin e aktiviteteve të shërbimit rimore vullnetar dhe aktiviteteve të tjera për të rinjtë.

12.1.2 Përfaqësimi dhe funksionimi i brendshëm demokratik i KVRL-së

12.1.2.1 KVRL duhet të siguroj përfaqësim të njëjtë për të gjithë të rinxjtë e organizatave rimore duke zbatuar parimin e barazisë dhe mos diskriminimit. KVRL në aktin e themelimit do të përcaktoj numrin dhë organizatat që do të përbëjnë anëtarësinë e Këshillit.

12.1.2.2 KVRL do të siguroj funksionim të brendshëm demokratik në përputhje me standarde ndërkombëtare dhe në bazë të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare nr. 03/L-134.

12.1.3 Procedurat për regjistrim dhe njohjen e KVR-së, si dhe raportimi i KVRL-së

12.1.3.1 KVRL është person juridik i cili duhet të regjistrohet si i tillë në bazë të parimeve dhe procedurave të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare nr. 03/L-134. KVRL pas regjistrimit duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë autoritetetve komunale për njohjen e tij.

12.1.3.2 Komuna përgjegjëse pas konsultimit me DKRS-në do ti lëshojë një vendim KVRL-së për njohjen brenda 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, nëse plotësohen kushtet e parapara me UA nr. 9-2010.



12.1.3.3 Bashkë me kërkesën për njohje Këshilli duhet të bashkëngjis edhe dokumentet si në vijim:

12.1.3.1.1 Procesverbalin nga takimi i Kongresit themelues të Këshillit;

12.1.3.1.2 Dy kopje të aktit themeltar të Statutit, bashkë me kopjen e çertifikatës së regjistrimit;

12.1.3.1.3 Një kopje të rregullores së punës së Këshillit;

12.1.3.1.4 Listën informuese me emrat e organizatave rimore përfaqësuese në KVRL, që duhet të mbaj këto të dhëna:

- a. Një përshkrim për secilën organizatë (CV) nëse është aktive, të paktën për një vit para themelimit të Këshillit;
- b. Një listë të aktiviteteve të planifikuara;
- c. Emërtimin e plotë dhe të shkurtuar të organizatës;
- d. Selinë (vendndodhja, rruga dhe numri);
- e. Një kopje të çertifikatës së regjistrimit të OJQ-ve rimore;
- f. Emrin e përfaqësuesit të organizatës.

12.1.3.1.5 Nëse pas procesit të njohjes ndodhë çfarëdo ndryshimi sa i përket anëtarësimi, dokumenteve të themelimit apo ndonjë ndryshimi tjetër të Këshillit, brenda afait prej 8 ditësh do të njoftohet Drejtoria për rini në Komunë. Këto ndryshime në Këshill duhet të përcillen me një vendim nga organi me i lartë i KVRL-së.

12.1.3.1.6 Drejtoria për Rini e Komunës do të njoftohet menjëherë me të gjitha të dhënat lidhur me KVRL-në që do të njihet nga autoritetet komunale si dhe me çfarëdo ndryshimi brenda KVRL-së.

12.1.3.1.7 KVRL është i obliguar ti paraqes raport gjashtë mujor në Drejtorin Komunale për Rini lidhur me aktivitetet e zhvilluara për vitin kalendarik. Raporti narrativ dorëzohet në formë elektronike dhe në një kopje çdo fund viti, ndërsa Drejtoria përkatëse mund të kërkoj shpjegime shtesë.

12.1.4 Mbështetja financiare

12.1.4.1 Komuna do të mbuloj të gjitha shpenzimet që rezultojnë nga organizimi i Asamblesë së KVRL-së. Shpenzimet që Komuna mbulon: Shpenzimet administrative të sekretariatit; shpenzimet e udhëtimit për pjesëmarrës në Asamblenë e veprimit rinoj të Kosovës; shpenzimet për mëditje (vendosje dhe ushqim), sipas standardeve në fuqi; shpenzimet për shërbimet administrative të mbledhjes.

12.1.4.2 Komuna sipas mundësisë dhe nevojës mbulon shpenzimet tjera të veprimtarisë së KVRL-së.

13. QENDRA RINORE

13.1 Sipas Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, Qendra rinore ofron hapësirë për programet dhe veprimtaritë e të rinjve në bazë të statutit të tyre, ndërsa janë të hapura për të gjithë të rinjtë.

13.2 Qendra rinore e licencuar nga drejtoria komunale përgjegjëse për rini, sipas llojit dhe natyrës së saj, duke marrë parasysh strukturën, programet dhe mundësitë për përbushjen e detyrave që lidhen me zhvillimin fizik, mental, shoqëror dhe shpirtëror të të rinjve, ofron hapësirë, resurse dhe mundësi për zhvillimin e veprimtarive edukative joformale, si dhe të veprimtarive të tjera të planifikuara nga të rinjtë.

13.3 Drejtoria komunale përgjegjëse për rini, pas konsultimit me Këshillin e veprimit rinor lokal, do të licencoje me vendim komunal qendrat rinore, në përputhje me Ligjin dhe UA-në. Këshilli i veprimit rinor lokal do t'i shqyrtojë hollësishët të gjitha mundësitë dhe mënyrat për sigurimin e hapësirave publike, të mjeteve financiare, përkatësisht të burimeve komunale, me qëllim të mbështetjes së qendrave rinore në secilën komunë dhe, në veçanti, në zona rurale me numër të madh të të rinjve.

13.3.1 E drejta për licencim

13.3.1.1 Të drejtë e kërkesës për licencim si Qendra Rinore e kanë të gjitha OJQ-të të cilat janë të regjistruara pranë Ministrisë së Administratës Publike në bazë të ligjit dhe të cilat veprimtarinë kryesore e realizojnë në sektorin e rinisë.

13.3.1.2 Secila Komunë do të licencoje dhe të financoj të paktën një QR publike, po në bazë të kërkesave dhe nevojave mund të licencoje edhe qendra të tjera, por që nuk është e obliguar që ti financoj. QR-të mund të shtrijnë rrjet edhe në zona të tjera të komunës.

13.4.1 Kërkesa për licencim, mënyra dhe kushtet

13.4.1.1 Kërkesa për Licencim, komisioni për shqyrtim, kushtet dhe vendimi, si edhe hapa të tjerë janë të tregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 11-2010 për regjistrimin e Qendrave Rinore.

13.5.1 Komisioni për shqyrtimin e kërkesës

13.5.1.1 Pranë autoritetit komunal do të themelohet një komision për shqyrtimin e kërkesave për licencimin e qendrës, i cili komision do të ketë mandat deri në marrjen e vendimit për licencim të qendrës rinore në Komunë.

13.5.1.2 Ky komision do të themelohet në përbërje prej 3 anëtarëve:

- Një përfaqësues nga Drejtoria e buxhetit;
- Një përfaqësues nga DKRS-së
- Një përfaqësues nga KVRL.

13.5.1.3 Në Komunat në të cilat KVRL-të nuk janë funksional, anëtari i komisionit do të fitohet një përfaqësues nga këshilli i nxënësve i shkollave të mesme të komunës.

13.5.1.4 Në rast të përfaqësimit nga KVRL apo këshilli duhet të evitohet konflikti i interesit

13.5.1.5 Në rast ankesë nga qendrat rinore që aplikojnë për licencim nga komunat, Departamenti i Rinisë në Ministri formon një komision për vlerësimin e ankesave dhe ruan të drejtën për të ripërsëritur tërë procesin e licencimit. Komisioni, pasi të shqyrtoj kërkesat nxjerr një raport me rekomandime për DKRS-në dhe Kryetarin e Komunës.

13.6.1 Vendimi për licencim

13.6.1.1 Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të kërkesave për licencimin e qendrave, kryetari i komunës në bazë të rekomandimeve dhe raportit do të nxjerr vendim për licencimin e qendrës.

13.6.1.2 Vendimi për kohëzgjatjen e licencës së Qendrës Rinore Publike jepet duke u bazuar në kërkesën e bërë nga organizata, duke u vlerësuar kushtet e operimit dhe programit me mundësi përmbushtjeje përafat të caktuar të viteve të operimit.

13.7.1 Refuzimi i licencimit, e drejta për ankesë

13.7.1.1 Në rast të mos plotësimit të kushteve sipas UA, komisioni për shqyrtimin e kërkesës rekomandon refuzimin e kërkesës për licencim. DKRS-ja do të njoftoj më shkrim për refuzimin dhe arsyet. Aplikuesi ka të drejtë të parashtroj ankesë sipas procedurave administrative dhe procedurave gjyqësore.

13.7.1.2 Secila Qendër Rinore, OJQ që e konsideron së i është bërë shkelja e të drejtës për licencim, ka të drejtën e ankesës sipas procedurave në fuqi.



14. FUSHAT STRATEGJIKE TE PLVR-së

Plani Lokal i Veprimit Rinor për komunën e Klinës është përgatitur në përputhshmëri me objektivat strategjike të dala nga Strategjia Kosovare për Rini 2013-2017 të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe duke iu përshtatur gjendjes dhe nevojave socio-ekonomike të grup-moshave 15-24 vjeç të cilat jetojnë në këtë komunë.

14.1 Pjesëmarrja e rinisë dhe përfaqësimi i saj në institucionet publike

Në kuadër të hartimit të PLVR-së, KOHA ka organizuar një sërë takimesh me aktorë të ndryshëm aktiviteti i të cilëve ndërlidhet me fushëveprimin e rinisë. Punëtoritë e organzuara, me pjesëmarrje të Organizatave të Shoqërisë Civile, Qendrave Rinore, Këshillave Rinor Partiak dhe Këshillave të Shkollave të Mesme dhe Filllore, kanë rezultuar me gjetje të cilat flasin për një angazhim tejet të ulët të rinisë në jetën publike.

Të njëjtat gjetje flasin veçanërisht për një përfaqësim të ulët të këtyre të rinjve pranë institucioneve publike, si dhe mos informim mbi ligjet e veçanta të cilat i garantojnë pjesëmarrje në proceset vendim-marrëse kësaj grup-moshe.

Në pyetësorin e përpiluar nga KOHA dhe të shpërndarë tek 337 nxënës të shkollave të mesme dhe filllore të komunës së Klinës, përgjigjet e dhëna nga nxënësit kanë rezultuar me mangësi në procesin e informimit të këtyre të rinjve nga ana e zyrtarëve Komunal, si dhe me mosnjohje të Ligjit për Rini.

Në pyetjen se sa janë njojuritë që këta të rinj kanë mbi Ligjin për Rini, atëherë del në pah se nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve: 73.59% nuk janë aspak të informuar, 18.69% kanë njouri mbi këtë ligj, kurse 7.72% nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen së a janë konsultuar këta të rinj nga ana e Komunës së Klinës mbi çështjet rino, përgjigjet kanë qenë si vijon: 13.06% janë deklaruar të janë konsultuar, 73.59% të mos janë konsultuar, kurse 6.82% nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje.

Kurse, në pyetjen se sa janë njojuritë e këtyre të rinjve mbi ligjet në përgjithësi të cilat ua garantojnë të drejtat në Republikën e Kosovës, rezultatet kanë qenë disi më të mira, dha janë shfaqur me këto shifra: 48.37% janë deklaruar të kenë njouri, 40.95% të mos kenë njouri, kurse pjesa e mbetur prej 10.68% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Rezultatet e lartshënuara janë dëshmuar edhe gjatë takimeve me aktorë të ndryshëm, të cilët gjatë punës së tyre kanë vërejtur një mospjesëmarrje të të rinjve në aktivitetet e tyre, dhe një hezitim për të qenë pjesë e vazhdueshme në jetën publike.

Pasojat e këtij rezultati duhet kërkuar në domenin e politikave qeveritare, të angazhimit të strukturave komunale, si dhe mungesës së informimit të këtyre të rinjve pranë strukturave shkollore ku ata vijojnë mësimet, veçanërisht këto rezultate janë të ndërlidhura me këto fusha:

- Mos informim i këtyre të rinjve mbi të drejtat e tyre;



- Mungesë e planeve zhvillimore, strukturave dhe aktiviteteve për këta të rinj nga ana e komunës;
- Mosinteresim i këtyre të rinjve për t'u angazhuar në jetën publike, si pasojë e kushteve të rënda socio-ekonomike.

14.1.1 Objektivi strategjik i pjesëmarrjes së rinisë dhe përfaqësimit të saj në institucionet publike

Rezultatet e paraqitura në këtë objektiv strategjik e dëshmojnë rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes së rinisë në jetën publike dhe në proceset e vendim-marrjes në fushat të cilat bien në domenin e këtyre të rinjve.

Deri më tash një pjesë e të rinjve janë informuar mbi ekzistimin e kornizës ligjore e cila iu garanton atyre të drejtat dhe i mundëson përfaqësimin dhe fuqizimin pranë strukturave komunale dhe atyre jo-qeveritare, përmes këtyre aktiviteteve që KOHA ka organizuar:

- Punëtori me Organizatat Jo-Qeveritare që në fokus kanë grup-moshat rinore;
- Punëtori me Qendrat Rinore;
- Shpërndarje e pyetësorit i cili ka përbajtur informata mbi ekzistimin e kornizës ligjore mbi përfaqësimin dhe fuqizimin e rinisë; dhe
- Punëtori me Këshillat e Nxënësve të Shkollave të Mesme dhe Fillore.

Rritja mëtutjeshme e përfaqësimit dhe fuqizimit të pjesëmarrjes së të rinjve në vendim-marrje, i rregulluar edhe me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, mëtohet të arrihet përmes:

- Vodosjes së një linje komunikimi mes Komunës së Klinës, përkatësisht DKRS-së dhe grup-moshave të reja në fushat të cilat ngërthejnë aktivitete rinore;
- Zhvillimin e një linje komunikimi mes DKRS-së dhe DKA-së pranë Komunës së Klinës mbi mundësinë e informimit dhe azhurnimit të këtyre informacioneve për nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore;
- Rrjetëzimit dhe bashkërendimit të aktivitetave të Organizatave të Shoqërisë Civile, Drejtive Komunale, Institucioneve Publike dhe Organizatave Ndërkombëtare të cilat në fokus të punës së tyre kanë edhe grup-moshat 15-24 vjeç, përkatësisht rininë e kësaj komune.

14.2 Edukimi jo-formal i të rinjve

Edukimi jo-formal mbetet njëri nga objektivat strategjike më të panjohura për të rinjtë, si në nivelin qendror po ashtu në atë lokal.¹

¹ Strategjia Kosovare për Rini 2013-2017 në mbledhjen e të dhënave statistikore mbi edukimin jo-formal ka intervistuar 100 të rinjë, nga të cilët 68% nuk janë të informuar mbi edukimin jo-formal.

Në nivelin lokal, nga 337 të rinj pjesëmarrës në mbledhjen e të dhënave statistikore vetëm 15.72% janë përgjigjur të kenë njohuri mbi edukimin jo-formal, 75.67% të mos kenë fare njohuri, kurse 8.61% nuk kanë dhënë ndonjë përgjigje.

Në bazë të këtyre të dhënave rezulton se të rinjtë në përgjithësi nuk janë të informuar mbi edukimin jo-formal dhe rëndësinë e këtij edukimi në zhvillimin e karrierës së tyre.

Faktorët kryesorë në mungesën e njohurive të këtyre të rinjve mbi edukimin jo-formal është mungesa vijës komunikuese me zyrtarët Komunal, si dhe mungesa e një qendre kryesore rinore e rregulluar nga pikëpamja ligjore e cila do ishte vend-takim për zhvillimin e aktiviteteve të edukimit jo-formal. Në këtë aspekt, rregullimi ligjor i Qendrës Rinore në Klinë do iu mundësonë të rinjve njohjen dhe vlerësimin e edukimit-jo formal. Qendra "Ardhmëria" e cila zhvillon aktivitete në kuadër të Qendrës Rinore ka shprehur shqetësimin me mungesën e interesimit nga ana e të rinjve për të qenë pjesë e aktiviteteve të organizuara nga kjo qendër dhe organizatat tjera.²

14.2.1 Objektiva strategjike e edukimit jo-formal

PLVR do të mëtojë që të arrijë një bashkërendim mes aktorëve qeveritar dhe atyre jo-qeveritar, duke përfshirë edhe aktorë të tjerë të cilët në fokus kanë grup-moshat rinore, në mënyrë që të arrihet një përfshirje sa më e madhe e të rinjve në domenin e edukimit jo-formal. Në të njëjtën kohë, ky plan do të jetë bazë për krijimin e bashkëpunimit në mes të DKRS-së, MKRS-së, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe Organizatave Ndërkombëtare në arritjen e strategjisë e cila del nga Strategjia Kosovare për Rininë, si dhe të objektivave që dalin nga e njëjta Strategji. Kjo strategji dhe këto objektiva do të përfshinin fushat vijuese:

- Hartimin e udhëzimeve dhe përkrahjen për Qendrat Rinore nga Komuna dhe partnerët e tjerë (strategji);
- Ngritja e shkathtësive të liderëve rinor përmes edukimit jo-formal;
- Njohja e certifikimit nga ana shoqërore dhe institucionale e edukimit jo-formal;
- Përkrahja e Qendrave Rinore qe merren me edukimin jo-formal;
- Stimulimi i shërbimeve shoqërore përmes punës vullnetare dhe shkëmbimeve rinore jashtë vendit;
- Ngritja e kapaciteteve rinore organizative dhe menaxhuese.

14.3 Punësimi dhe ndërmarrësia

Gjetja e statistikave mbi punësimin dhe ndërmarrësin e të rinjve në komunën e Klinës ka qenë e pamundur. KOHA në kuadër të aktiviteteve për hartimin e PLVR-së, përkatësisht të evidentimit të nevojave të grup-moshave rinore në rrashin e punësimit dhe ndërmarrësi, i është drejtuar Zyrës për Punësim në Klinë duke kërkuar statistika mbi kërkosat për punësim, numrin e të punësuarve dhe atyre të papunë. Kërkesa, duke qenë e

² Drejtuesit e Qendrës "Ardhmëria" shprehen se mosinteresimi i të rinjëve për të qenë pjesë e aktiviteteve dhe punës vullnetare është gjendja e rëndë socio-ekonomike prezente në komunën e Klinës.



bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, nuk ka hasur në ndonjë përgjigje nga ana e kësaj zyre me arsyetimin se këto të dhëna statistikore ende nuk janë kategorizuar në grup-mosha, ashtu siç parashihet nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Po ashtu, të dhënat statistikore të publikuara nga ana e MPMS-së në raportin Informatat mbi Tregun e Punës (Qershor 2014) jepin vetëm shifra të përgjithshme të një numri prej 97,538 të të rinjve 15-24 si të papunë.³

KOHA në pyetësorin e shpërndarë tek nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore, në pyetjen se çfarë këta të rinj mendojnë të bëjnë pas përfundimit të shkollës së mesme, ka arritur të ketë këto përgjigje: 107 (31.75%) pjesëmarrës janë deklaruar se do dëshironin të gjenin punë; 278 (82.49%) pjesëmarrës janë deklaruar se do dëshironin t'i vazhdonin studimet; 113 (33.53%) pjesëmarrës janë deklaruar do dëshironin të largohen nga vendi. Në bazë të këtyre statistikave del që perceptimi në mesin e të rinjve mbi mundësinë e angazhimit te tyre në punë është fare i ulët, si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike e cila sipas perceptimit të këtyre të rinjve nuk do të mund të krijojë vende të reja pune.

14.3.1 Objektiva strategjike e punësimit dhe ndërmarrësi

Pasi që Komuna e Klinës për herë të parë do të ketë PLVR-në, i cili plan për t'u realizuar sa më mirë do duhej të përbante të dhëna statistikore rrëth punësimit dhe ndërmarrësi së grup-moshave 15-24 vjeçare, atëherë si fazë e parë e realizimit të këtij objktivi strategjik do të ishte kategorizimi i të dhënavë statistikore, duke pasur parasysh se pa kategorizimin e këtyre statistikave është e vështirë të përpilohen strategji dhe objektiva për t'u arritur. Faza e dytë do të përfshinte një bashkërendim dhe zgjerim aktivitetesh në këto fusha:

- Bashkërendim në mes të dikastereve të ndryshëm komunal dhe institucioneve të tjera publike që veprojnë në komunën e Klinës në kategorizimin e profesioneve të këtyre të rinjve;
- Evidencimi i fushave ku ndihet mungesë e personave të përgatitur në rrafshin e punësimit dhe ndërmarrësi;
- Informim sa më të gjërë të të rinjve mbi ekzistimin e Qendrave të Aftësimit Profesional;

Bashkëpunim mes Zyrës për Punësim në komunën e Klinës, Qendrave të Aftësimit Profesional dhe Ndërmarrjeve Private për organizimin e trajnimeve profesionale për të rinjtë në fushat ku më së shumti ka nevojë.

14.4 Shëndeti, edukimi dhe promovimi shëndetësor

³ Numri prej 97,538 të personave të papunë bie në domenin e grup-moshave 15-24 vjeçare, megjithatë kjo shifër është në nivel vendi pa qenë e kategorizuar në numrin e të papunëve që i ka secila nga komunitat e Republikës së Kosovës.

KOHA në kërkësën e saj, të bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, drejtuar Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Klinë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje rrith edukimit dhe promovimit shëndetësor për të rinj të moshës 15-24 vjeç. Arsyja për mosdhënien e këtyre informative ka qenë mos kategorizimi i të dhënave statistikore.

KOHA në anketimin e saj ka arritur të evidentojë këto të dhëna në fushën e edukimit dhe promovimit shëndetësor:

Nga 337 pjesëmarrës në anketim, përgjigjet në pyetjen se sa ka qenë pjesëmarrja në ligjëratat edukative kanë qenë këto: 149 (44.21%) janë përgjigjur të kenë qenë pjesëmarrës në këto ligjëratat; 160 (47.48%) janë përgjigjur të mos kenë qenë pjesëmarrës në këto ligjëratat; 28 (8.31%) nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Është pyetjen se sa nga këta të rinj kanë njohuri mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme, përgjigjet kanë qenë si vijon: 177 (52.52%) janë përgjigjur të kenë njohuri rrith këtyre sëmundjeve; 130 (38.58%) janë përgjigjur të mos kenë njohuri; 30 (8.90%) nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Është pyetjen nëse këta të rinj kanë provuar ndonjëherë narkotikë apo substanca alkoolike, përgjigjet kanë qenë si vijon:

- Duhan
- Po: 26 (7.72%)
- Jo: 300 (89.02%)
- Nuk janë përgjigjur: 11 (3.26%)

- Alkool
- Po: 40 (11.87%)
- Jo: 288 (85.46%)
- Nuk janë përgjigjur: 9 (2.67%)

- Drogë
- Po: 2 (0.59%)
- Jo: 317 (94.07%)
- Nuk janë përgjigjur: 18 (5.34.08%)

14.4.1 Objektivi strategjik i shëndetit, edukimit dhe promovimit shëndetësor



Duke pasur parasysh që parandalimi, eventualisht dhe kurimi i sëmundjeve të ndryshme transmetuese, i fenomeneve negative në mesin e grup-moshave 15-24 vjeçare, atëherë faza e parë e këtij rezultati do të përfshinte kategorizimin e të dhënave statistikore në këtë fushë për këta të rinj.

Faza e dytë do të kishte për qëllim aktivitetet vijuese:

- Organizimin e ligjëratave edukative për të rinj në bashkëpunim mes DSHMS-së, QKMF-së, shkollave të komunës së Klinës dhe organizatave të shoqërisë civile;
- Përfshirjen sa më të gjerë të grup-moshave 15-24 vjeçare në edukimin shëndetësor;
- Bashkërendim mes institucioneve shëndetësore qendrore dhe lokale me dikastere të ndryshëm komunal në përgatitjen e politikave publike në parandalimin e sëmundjeve dhe fenomeneve negative.

14.5 Siguria njerëzore

Në kërkesën që KOHA i ka drejtuar Policisë së Kosovës-Stacionit në Klinë, duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, ka arritur qe jo-formalisht të marr këto të dhëna statistikore mbi numrin e të pandehurve të grup-moshave 15-24 vjeçare: në vitin 2013 numri i të pandehurve ka qenë 110 individë; kurse, në vitin 2014 numri i të pandehurve ka qenë 80 individë.

Në bazë të këtyre statistikave shihet se numri i veprave të paraqitura në polici ka shënuar rënje, megjithatë problem kryesor në këtë rrafsh ende mbetet mos kategorizimi i këtyre veprave në bazë të të cilave akuzohen këta të rinj.

KOHA në pyetësorin e saj ka parashtruar pyetjen, se sa ndjehen këta të rinj të sigurt në shkollë, rrugë dhe vendbanimet e tyre, duke përfituar këto përgjigje: 241 (71.51%) janë përgjigjur të ndihen të sigurt; 67 (8.61%) të mos ndihen të sigurt; 29 (7.09%) nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Ndërlidhja në mes të këtyre të dhënave statistikore dhe të dhënave statistikore të lartshënuara në objektivin Promovimi dhe Edukimi Shëndetësor tek përdorimi i substancave narkotike dhe atyre alkoolike, na tregon për një nivel relativisht të ulët të përdoruesve dhe për një nivel relativisht të lartë të sigurisë publike. Megjithatë, duke pasur parasysh që siguria publike përbën një ndër elementet kryesore të zhvillimit të gjithmbarshëm, atëherë lind nevoja për një vigjilencë edhe më të lartë dhe bashkërendim i institucioneve qendrore, atyre komunale dhe strukturave të sigurisë në parandalimin e fenomeneve negative, përkatësisht uljen e këtyre përqindjeve negative të paraqitura këtu. Mësimdhënësit e shkollave të mesme nga një takim i realizuar në vitin 2013 nga ana e Forumit për Iniciativa Qytetare dhe OJQ KOHA kanë shprehur brengat e tyre për ndryshimet tek nxënësit dhe mundësitet e lehta për qasje në narkotik.

14.5.1 Objektivi strategjik i sigurisë njerëzore



Siguria si një nga elementet bazë të zhvillimit shoqëror do të ketë në fokus të saj edhe grup-moshat 15-24 vjeçare, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative, si dhe në rritjen e mëtutjeshme të sigurisë së gjithmbarshme.

Një kujdes i shtuar do t'i kushtohej ambienteve të cilat frekuentohen nga të rinjtë e shkollave fillore dhe të mesme.⁴ Këtu përfshihen ambientet brenda dhe rreth objekteve shkollore, vigjilencë e shtuar në rrugët e frekuentuara për shkuarje-ardhje në shkollë, si dhe një vigjilencë më e madhe në hapësirat ku nxënësit në mbrëmje presin mjetet e udhëtimit për t'u kthyer në vendet ku banojnë.⁵

Në mënyrë që ky objektiv të arrihet, atëherë është i nevojshëm bashkërendimi i institucioneve publike në këto fusha:

- Kategorizimi i të dhënave statistikore nga ana e Policisë së Kosovës të veprave të kryera nga të rinjtë e grup-moshave 15-24 vjeçare;
- Bashkërendim mes dikastereve Komunal më Policinë e Kosovës në ngritjen e sigurisë në tërë territorin e komunës së Klinës;⁶
- Bashkërendim në mes të DKA-së, Policisë së Kosovës, Inspektoratit dhe drejtorive të shkollave fillore në parandalimin e fenomeneve negative.

14.6 Sporti, kultura, rekreacioni dhe vullnetarizmi

Kushtet për zhvillimin e aktiviteteve rimore në komunën e Klinës deri me tash kanë qenë të mangëta. Po ashtu edhe informimi i të rinjve, përkatesisht grup-moshave 15-24 vjeçare, ka shënuar mungesa duke u kthyer në një nga elementet të cilat kanë ndikuar në pjesëmarrje të vogël të të rinjve në aktivitete. Krahas mungesës së infrastrukturës dhe mos informimit, një element tjetër që ka ndikuar në mospjesëmarrje aktive të të rinjve në jetën dhe aktivitetet shoqërore ka qenë edhe buxheti i ulët i DKRS-së në fushëveprimin e zhvillimit të këtyre aktiviteteve.

KOHA në pyetësorin e saj ka parashtruar pyetjen, se a ka kushte (infrastrukturë) të mjaftueshme për zhvillimin e aktiviteteve rimore, ka arritur të marrë këto përgjigje: 118 (35.01%) janë deklaruar se ekzistojnë këto kushte; 185 (54.90%) janë deklaruar të mos ekzistojnë këto kushte; kurse, 34 (10.09%) nuk janë përgjigjur fare në këtë pyetje.

⁴ Në raportin e saj të publikuar në Korrik të vitit 2010 e protokolluar në Komunë, KOHA kishte cekur problematikat ekzistuese në rrethin e ambienteve të shkollave të mesme në Klinë në rrashin e sigurisë njerëzore, si dhe kishtë dhënë rekondimet e saja në eliminimin e këtyre problematikave (raporti është i publikuar në faqen e OJQ KOHA në facebook).

⁵ Në mungesë të një stacioni autobusësh, nxënësit janë të detyruar të mblidhen në hapësira të ndryshme të qytetit, të papercaktuara zyrtarisht, për të udhëtuar drejt vendbanimeve të tyre.

⁶ Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe ajo e Inspektorati pranë Komunës së Klinës do duhej të kishte një bashkërendim më të thelle me Policinë e Kosovës dhe me organizata të tjera përkatëse në mbrojtjen e nxënësve nga ndonjë sulm eventual që do mund të vinte nga qentë endacak, duke e trajtuar këtë çështje ne bazë të ligjeve dhë rregulloreve në fuqi të cilat bien në domenin e kësaj problematike.



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Departamenti i Rinisë

Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Optina Klinë

Ndërsa, në pyetjen se sa këta të rinj kanë njohuri rrith ekzistimit të KVRL-së dhe Qendrës Rinore, pjesëmarrësit në këtë pyetësor kanë dhënë këto përgjigje: 91 (27.00%) janë deklaruar të kenë njohuri; 219 (64.99%) janë deklaruar të mos kenë njohuri; 27 (8.01%) nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.

Në punëtoritë që KOHA ka organizuar në kuadër të hartimit të PVRL-së, perceptimi i përgjithshëm ka qenë se në komunën e Klinës mungojnë si infrastruktura, po ashtu edhe aktivitetet të cilat bien ne fushëveprimin e grup-moshave 15-24 vjeçare.

Vullnetarizmi është çështje ende jo e zhvilluar mirë, andaj edhe mos angazhimi dhe mos njohja e punës vullnetare përmes certifikatave ka ndikuar në hezitim e të rinjve për të qenë më aktiv ne shoqëri, dhe ende puna në komunitet nuk është në nivelin e duhur në Komunën e Klinës.

14.6.1 Objektivi Strategjike i sportit, kulturës dhe rekreacionit dhe vullnetarizmit

Gjatë punëtorive në kuadër të hartimit të PLVR-së, si dhe gjatë përpunimit të të dhënave statistikore nominale, KOHA ka arritur të vë në sipërfaqe disa rekomandime. Këto rekomandime, të cilat në këtë rast përkijnë me mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme rinore, përfshijnë këto fusha dhe pritje:

- Më shumë aktivitete kulturore, sportive dhe argëtuese për të rinjtë;
- Më shumë infrastrukturë për zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- Ndërtimin e një Qendre Rinore të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve rinore;
- Një bashkëpunim më i thellë mes DKRS-së, DA-së, shkollave të komunës së Klinës dhe organizatave të shoqërisë civile në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve për rininë;
- Ri-funksionalizimin e KVRL-së, si dhe përfshirjen e këshillave të nxënësve të shkollave dhe OJQ-të lokale aktive në proces të ri-funksionalizimit dhe në takimet e ardhshme të KVRL-së;
- Organizim kursesh dhe aktivitetesh të veçanta për të rinjtë me nevoja të veçanta;
- Bashkëpunim me komunat me të cilat komuna e Klinës është binjakëzuar, duke bërë shkëmbime kulturore në mes të rinjve;
- Shpërndarje bursash për studentë dalluar të komunës së Klinës dhe stimulime të tjera;
- Rritje e socializimit ndërmjet të rinjve përbreda komune, në nivel vendi dhe jashtë Kosove përmes aktiviteteve të ndryshme edukative, kulturore, sociale, shërbimeve të komunitetit, punëtorive apo shkëmbimeve të ndryshme;
- Përkrahja dhe stimulimi i punës vullnetare, si dhe lëshimi i dëshmive për punë vullnetare nga ana e Komunës, OJQ-ve apo trupa të tjerë.

15. AKTIVITETET E PARAPARA PËR VITET 2015-2016

15.1 Aktivitetet e parapara synojnë arritjen e objektivave të PLVR-së në Komunën e Klinës për vitin 2015-2016.

15.2 Aktivitetet e parapara janë edhe Plan veprimi për DKRS-në, përkatësisht sektorin për rini në Komunën e Klinës dhe marrin mbështetje financiare nga buxheti i Komunës së Klinës.

15.3 Komuna, përkatësisht DKRS, mund që aktivitetet e parapara ti realizojnë edhe në bazë të donacioneve të ndryshme nga partneriteti me organizata lokale, nationale apo ndërkombëtare përmes realizimit të projekteve dhe iniciativave të ndryshme në territorin e Komunës së Klinës.

15.4 Buxheti dhe aktivitetet mund jenë të ndryshueshme varësisht shpenzimeve në linjat buxhetore apo përfshirje të aktorëve të tjera si formë ndihme në realizimin e objektivave.

15.5 Partner të ndryshëm, publik apo privat, mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave të PLVR-së, por duhet të konsultohet dhe njoftohet paraprakisht DKRS.

15.6 Aktivite për të rinj, bazuar në Strategji dhe të tjera mund të realizohen edhe pa kosto (të madhe) financiare, duke përfshirë staf komunal të profilizuar në një fushë të caktuar e që mund të kontribuonin krahas punës ditore (p.sh. profesorët e artit në administratë mbajnë kurse dhe garë arti, aktorët zhvillojnë aktivitete me të rinj dhe për të rinj, sala e kulturës në shërbim të të rinjve, duke pasur shfaqje apo trajnime e aktivitete të ndryshme kulturore).

15.7 Rekomandimi dhe kërkesat e shumta nga ana e të rinjve për ndihme studenteve përmes bursave presin një vendim tjetër të Ekzekutivit dhe Legjislativit të Komunës së Klinës dhe kjo linj nuk ekziston në këtë buxhet dhe listë aktivitetesh.

15.8 Shuma totale e buxhetit për vitin 2015 është paraparë të jetë: 15,050.00 Euro.

15.9 Shuma totale e buxhetit për vitin 2016 është paraparë të jetë: 29,700.00 Euro.


16. TABELA E AKTIVITETEVE PËR VITET 2015-2016

Koment	Aktivitet	Rezultati e arritshme	Institucionet përgjegjëse	Institucionet partner	Afati kohor		Burxhi
					2015	2016	
	Fuqizimi ihe licencimi i qendrës rimore	Krijimi kushteve elementare për punë dhe funksionin; Licencimi i QR-së	DKRS	MKRS dhe partner të ndryshëm	1000,00€	3500,00€	4500,00€
	Përkrahje dhë fuqizim i KVRL-së, pajisje dhë inventar për zyrë; Kuvendi zgjedhor dhë raportimi vjetor	Kushte Elementare Për Funksionin Dhe organizim	DKRS	MKRS, dhe Partnerë Ndryshëm	300,00€	400,00€	700,00€
	Organizimi i kampanjave për dhurimin e gjakut dhe aktivitete tjera solidarizuese	Promovimi i punës vullnetare me grupe multietnike në qytet	Sektori i Rinise KVRL, Kryqi i Kuq	DSHMS; OJQ-të, Keshillat e nxenesve	200,00€	300,00€	500,00€
	Aktivitet kulturore dhe sportive, gara të ndryshme në art, muzikë, fotografji, sport (not dhe peshkim në lumin Drini i Bardhë), maratona*, turnir shkollash, maratona e bicikles – shpërbilime modeste	Angazhami i të rinjëve dhe promovimi i vlerave natyrore e kulturore në Komunë	Sektori i Rinise	DKA, DKRS; MKRS, KVRL OJQ, Bizneset Private e Partnerë të tjere	2500,00€	3500,00€	6000,00€
	Shërimi i dites ndërkombëtare te ambientit	Promovimi i rënësise se rrapjes se ambientit, pastrimi i qytetit	Drejtori e Urbanizmit, Shtëpimeve Publike, dhe Arsimit dhe partner të tjere; DKRS	DKRS, OJQ dhe grupet vullnetare; Bizneset private	500,00€	700,00€	1200,00€



Seminare r. pautori dhe trajnime PLVR 2016 -	Nxjerra e nevojave plotësuese për të rinjët si dhe marja e ideve për plotësimin e PVRL.	DKRS; DKA; DSHMS	MKRS; OJQ; KVRL; QR; Këshillat e shkollave		500,00€	2000,00€	2500,00€
Hulumtime dhe Analiza mbi gjendjen e të rinjve në qytet dhe zona rurale.	Mbledhja e të dhënave të sakta mbi gjendjen dhe nevojat e të rinjve	DASH	DKRS,OJQ		200,00€	400,00€	600,00€
12 Gusht - dita Ndërkombëtare e Rinisë	Angazhim përmes aktiviteve edukative dhe promovim të vlerave kulturore-sportive	DKRS DKA	MKRS; OJQ-të; dhe sektori privat		1000,00€	1500,00€	2500,00€
Tryrra, takime, debate, fushata veçolijesuese mbi pjesëmarrjen në vendimmarrje	Aktivizim dhe informimi mundësitet Komunale, Vendimmarrja, përfaqësimi dhe Pjesëmarrja, Bashkëpunimi Komune-OJQ	DKRS KVRL	OJQ-të; MKRS;		400,00€	600,00€	1000,00€
Themelimi i grupeve jo formale të të rinjve në zonat rurale	Aktivizimi i të rinjve në mënyrë të organizuar	DKRS KVRL	OJQ-të rinore		200,00€	400,00€	600,00€
Motivimi i të rinjve në bibliotekë	Ofrimi me librin dhe nxjera për lexicum përmes këtyre bibliotekave; Vizita e promovim libri e Bibliotekë (salles së leximit)	DKA, DKRS	MASHT, Biblioteka ndërkombunale dhe donator tjerë		400,00€	700,00€	1100,00€

KOHA

Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Dëpartamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Optikë Klinë

	Përprahje e Këshillave të nxënësve	Organizim, aktivizim dhe informim mbi mundësitë e angazhimit	DKRS DKA	KVRL MKRS OJQ QR		150,00€	300,00€	450,00€
	Edukim Jo-Formal	Trajnimet dhe angazhim i të rinjve, sidomos atyre që kanë braktisur shkollimin apo me aftësi të kufizuar	DKRS DKA KVRL	OJQ MKRS Business private dhe shkollat profesionale		500,00€	1500,00€	2000,00€
	Ngritje kapacitetesh për KVRL, QR, Këshilla rino, grupe formate dhe jo formale dhe OJQ lokale rino	Trajnim me tema Si te shkruash projekt, kerkimi i donatoreve, Zbatimi dhe raportimi i projekteve. Pergatija e CV dhe letër motivacioni	DKRS KVRL QR	OJQ MKRS		200,00€	500,00€	700,00€
	Kurse për art, muzikë, valizim, aktësim, gjohë të huaja, kompjuter, etj					1000,00€	2000,00€	3000,00€
	Fushata informuese mbi shëndetin	Fushata edukative më nxënës dhe të rinj të tjera mbi sëmundje të trajmstueshme dhe ushqimin e shëndetshëm	DSHMS DKA DKRS	KVRL QR MKRS		500,00€	800,00€	1300,00€
	Grante të vogla stimuluese	Grante të vogla për gjatë vizit në fusha të ndryshme interesit përfshi, ku shpikojnë të rinj individual apo grupe të organizuara në OJQ apo tjera, formale dhe jo formale	DKRS	KVRL OJQ		1000,00€	2000,00€	3000,00€
	Konferenca "të rinjt në vendimtarje"	Të rinjt në vendimtarje, mundësita dhe përgjegjësia e ndërsjellta	DKRS KVRL	MKRS OJQ		500,00€	500,00€	



Fushata veftidjesuese	Informim mbi të drejtën e votës, Regjistrim në zyrën e punësimit	DKRS DSHMS KVRL Zyra për punësim	OJQ-ës			500,00€	500,00€
Panaire apo shpërblime talenteve të rinj	Stumulime në formë financiare Talentevë të rinj të të dy gjinive dhe pagesë e dy semestrave të parë në UP	Komuna, DKRS KVRL	MKRS DKA		500,00€	1000,00€	1500,00€
Dita e Evropës 9 Maj	Shënim i kësaj dite me aktivitetë të ndryshme duke Rrit njohurit treth BE-së dhe integrimeve Maratonë me bicikleta dhe aktivitetet e ndryshme	DKRS KVRL Zyra për Integrimë Evropiane	OJQ MKRS Organizma tjere Lokal e nacional, si dbe nderkombetare		400,00€	500,00€	900,00€
Dita Evropiane e Parqeve - 24 Marsi	Ngritura e veftidjes tek të rinjt për rëndësinë e parqeve që ruajtjes së natyrës, Lobiimi për më shumë hapësim të gjejmërtësia dhe parqe në komunë	DKRS KVRL DURM DSHP	OJQ		200,00€	400,00€	600,00€
Muaji i Rinisë	Promovimi i të drejtave të të rinjve, mobilizim dhe aktivitetet e ndryshme, Bashkëpunimi aktivitetesh me OJQ dhe projekte të tjera	DKRS MKRS KVRL	OJQ DKA		1100,00€	1000,00€	2100,00€
Shfaqje teatrale, Filma, koncerte	Me qelim socializimi, mundësive për angazhim dhe shikueshmëri tek të rinjtë	DKRS			1000,00€	2500,00€	3500,00€
18 Qershor - Dita e Clirimit 17 Shkurti - Dita e pavareisë	Aktivitete e gara sportive, edukative e kulturore	DKRS DKA KVRL	OJQ MKRS		1000,00€	1000,00€	2000,00€



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Optima Klinë

	Dita e studenteve në komunitet - 31 Tetor	Bashkimi ndërmjet studenteve të Komunës, Tryezë/ diskutime, Mundësi paraqitje, promovimi dhe Argëtimi, Dhe regjistrimi i një database me student profilesh të ndryshëm	DKRS KVRL	OJQ		500,00€	900,00€	1400,00€
	Tashme ndërmjet DKRS dhe akterëve rinas lokale	Diskutimi i cështjeve me rëndësi për rininë e Klinës, Projektit e ndryshme dhe mundësitë e aplikimit, Kordinimi i aktiviteteve dhe i zhbatimit të PLVR-së, Ndarja e informacionit dhe realizimi i aktivitetave rinasore.	DKRS KVRL	OJQ; QR		200,00€	300,00€	500,00€

ⁱ Gara në sportin e notit dhe peshkimi bëhet në lumin Drini i Bardhë më qëllim promovimi dhe ruajtjeje të vlerave tona natyrore dhe synohet të bëhet garë tradicionale.

ⁱⁱ Maratona do të mbahet me datë 28 Mars të secilit vit dhe do të jetë garë tadicionale në kujtim të eksosit masiv që kanë përfjetuar qytetarët e Komunës së Klinës. Kjo garë realizohet me përfshirjen e secili të ri të regjistruar paraprakisht me përfshirje të një numri të caktuar edhe për secilen shkollë të komunës. Modalitetet tjera caktohen më një dokument të veçantë.



| Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Opština Klinë

**ANEKS
i
DRAFT
Planit Lokal të Veprimit për Rini
2015 - 2016**

Klinë, Shkurt 2015



Fig. 1.1 - Harta e Komunës së Klinës më të gjitha vendbanimet

Plani Lokal i Veprimit Rinor 2015-2016 si dokumenti më i rëndësishëm për rinin e Klinës është punuar me përkushtim dhe kujdes nga Organizata Joqeveritare KOHA dhe me mbështetje financiare nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Angazhimi i OJQ KOHA-së ka ardhur si rekomandim i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Klinës për shkak të mungesës së zyrtarit Komunal për rini dhe kapaciteteve brenda Drejtorisë. Punimi i këtij plani është bërë në bashkëpunim të plotë më DKRS-në duke u përshtatur me mundësitë e politikave publike Komunale dhe duke u diskutuar hollësisht me aktorë në lëmi të ndryshme si në nivel lokal po ashtu në atë nacional.



1.

Rekomandimet të përgjithshme nga puntoritë, anketimet dhe takimet konsultative

Në kuadër të statistikave të përgjithshme me qëllim hartimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, OJQ KOHA ka përpunuuar edhe pjesën nominale të statistikave të dala nga takimet konsultative, puntoritë, intervisimi me të rinj. Qëllimi kryesor i kësaj pjese statistikore ka qenë nxjerra e rekomandimeve në fushat ku respondentët dhe përfaqësuesit rinor mendojnë se qeverisja komunale do duhej të bënte më shumë për të rinjtë.

Si rezultat i përpunimit të statistikave nominale dhe takimeve me akterët lokal rinor, KOHA ka arritur të nxjerrë këto rekomandime të cilat duhet të përfshijnë gjithë territorin e Komunës së Klinës dhe të jetë prioritet i Komunës së Klinës, përkatësisht, DKRS-së:

1. Më shumë aktivitete kulturore, sportive dhe argëtuese për të rinjë;
2. Më shumë infrastrukturë për zhvillimin e aktiviteteve rinore;
3. Më shumë informacion/ligjerata kulturore dhe edukative;
4. Ndërtimin e një Qëndre Rinore të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve më të rinjë;
5. Akreditimi i Qëndres Rinore (sic precizon Ligji dhe Udhëzimi Administrativ);
6. Qënder Rinore apo formë bashkëpunimi ndërmjet QR-së dhe grupeve rinorë në zonat rurale;
7. KVRL e zgjedhur në mënyrë të drejtë dhe më përfshirje të gjërë, aktive dhe në shërbim të të rinjve;
8. Zyre të pajisur për funksionimin e KVRL-së dhe QR-së (sic precizon Ligji dhe Udhëzimi Administrativ);
9. Krijimi i një kodi buxhetor për sektorin e rinisë dhe ndarje e buxhetit për zbatimin e PLVR-së;
10. Krijimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm ndërmjet sektorit të rinisë dhe institucioneve të tjera publike dhe private;
11. Fuqizimi i pjesëmarrjes në vendimmarrje;
12. Përkrahje e iniciativave për ngritje profesionale për të rinjt;
13. Mbështetje e iniciativave apo projekteve të ndryshmë në formë granti dhe stimulimi;
14. Siguri më shumë në shkolla dhe ambientet që të rinjt kalojnë kohen;
15. Më shumë punë dhe angazhim rinor;



16. Rrjetizim i Shoqatave të Shoqërisë Civile dhe ngritje e bashkëpunimit ndërmjet SHC dhe organeve komunale;
17. Ndarje e bursave për student;
18. Bibliotekë me sallë leximi adekuate dhe të pajisur mirë më libra të fushave të ndryshme;
19. Thëllim bashkëpunimi dhe shkëmbim informacioni ndërmjet institucioneve lokale, regionale e nacionale: Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport; Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për Shëndetësi dhe mirëqenie sociale; Drejtorisë së Administratës; Qëndres për punësim; Drejtorisë së Shërbimeve Publike; Drejtorisë së Urbanizmit, sektorit për Turizëm; Sektori për Trashëgimi Kulturore; Zyra për Barazi Gjinore; Zyra për Integrime Evropiane; Qëndres për Punë Sociale; Policisë së Kosovës; Qëndres Kryesore të Mjekësisë Familjare; Gjykatës Komunale;
20. Në mungesë të ndalesave dhe stacionit të autobusëve, ndërtimi e një stacioni autobusësh është vlerësuar nga të rinjt me shumë rëndësi për sigurinë e tyre dhe lehtësimin e udhëtimit.
21. Realizimin e intervistave dhe hulumtimeve të ndryshme me dhe për të rinj.

2.

Rezultatet e hulumtimit më të rinj të grup-moshës 15-24 vjec

Me qëllim të hartimit sa më efikas të PVRL-së, mungeses së të dhënave për grup moshën 15-24 vjec dhe mos pasjes së grupeve të organizuara në zonat rurale, OJQ KOHA ka zhvilluar një sëri aktivitetesh ndër të cilat ka qenë edhe aktiviteti i shpërndarjes së pyetesorëve në disa nga shkollat e komunës së Klinës, duke bërë të mundur edhe nxjerrjen e disa statistikave të cilat në përgjithësi ngërthejnë sfidat dhe priorititetet me të cilat ballafaqohen të rinjtë e kësaj komune;

Ky vëzhgim statistikor është bazuar në përgjigjet e 337 nxënësve mbi moshën 15 vjeçare, dhe ka përfshirë këto shkolla: 1. Gjimnazi në Klinë; 2. Shkolla e mesme profesionale në Klinë; 3. Klasë të 9-ta në Ujëmirë; 4. Klasë të 9-ta në Cabiq; 5. Klasë të 9-ta në Gllarevë; 6. Klasë të 9-ta në Sferkë; Klasë të 9-ta në Drenoc; 10. Klasë të 9-ta në Potërq; 10. Klasë të 9-ta në Budisalc.



Rezultatet e hulumtimit

1. Keni njohuri për Ligjin për Rini?
 - Po: 63 (18.69%)
 - Jo: 248 (73.59%)
 - Nuk janë përgjigjur: 26 (7.72%)

2. Dini për ekzistencën e Këshillit e Veprimit Rinor Lokal, Qëndren Rinore dhe rolin e tyre?
 - Po: 91 (27.00%)
 - Jo: 219 (64.99%)
 - Nuk janë përgjigjur: 27 (8.01%)

3. Jeni konsultuar ndonjeherë nga Komuna e Klinës për cështje rinore?
 - Po: 44 (13.06%)
 - Jo: 270 (80.12%)
 - Nuk janë përgjigjur: 23 (6.82%)

4. Keni njohuri mbi edukimin jo formal?
 - Po: 53 (15.72%)
 - Jo: 255 (75.67%)
 - Nuk janë përgjigjur: 29 (8.61%)

5. Jeni pjesë e ndonjë grupei shoqëror?
 - Po: 223 (66.17%)
 - Jo: 114 (33.83%)

6. A ka kushte (infrastrukturë) për zhvillimin e aktiviteteve për rini?
 - Po: 118 (35.01%)
 - Jo: 185 (54.90%)
 - Nuk janë përgjigjur: 34 (10.09%)

7. Keni informacione mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme (Aids, gonorrea ose blenorragjia, herpesi gjenital, hepatiti B, etj.)?
 - Po: 177 (52.52%)
 - Jo: 130 (38.58%)



- Nuk janë përgjigjur: 30 (8.90%)

8. Keni marrë pjesë në ndonjë ligjeratë edukative?

- Po: 149 (44.21%)
- Jo: 160 (47.48%)
- Nuj janë përgjigjur: 28 (8.31%)

9. Keni provuar ndonjeherë njëren nga këto?

Duhan

- Po: 26 (7.72%)
- Jo: 300 (89.02%)
- Nuk janë përgjigjur: 11 (3.26%)

Alkool

- Po: 40 (11.87%)
- Jo: 288 (85.46%)
- Nuk janë përgjigjur: 9 (2.67%)

Drogë

- Po: 2 (0.59%)
- Jo: 317 (94.07%)
- Nuk janë përgjigjur: 18 (5.34.08%)

10. A jeni i sigurtë ndjeheni i sigurt në rrugë, shkollë, fshat, lokale?

- Po: 241 (71.51%)
- Jo: 67 (8.61%)
- Nuk janë përgjigjur: 29 (7.09%)

11. Cfarë synoni pas përfundimit të shkollës së mesme (përgjigjet janë të dyfishta)?

- Punë: 107 (31.75%)
- Studime: 278 (82.49%)
- Ikje jashtë shtetit: 113 (33.53%)

12. Dini për të drejtat që të rinjve iu garantojnë Ligjet në përgjithësi?

- Po: 163 (48.37%)
- Jo: 138 (40.95%)
- Nuk janë përgjigjur: 36 (10.68%)



Organizata Jo Qeveritare



Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë



Komuna e Klinës
Municipality of Klinë-Opština Klinë

5

Draft Pyetësori (i hulumtimit), i përdorur për të nxjerrë gjendjen dhe nevojat e rinisë në Komunën e Klinës



Organizata Jo Qeveritare



Departamenti i Rinisë

Emri dhe mbiemri: _____

Shkolla: _____

Pjetësor mbi gjendjen dhe nevojat e rinisë në komunën e Klinës

Ky hulumtim organizohet nga Organizata Joqeveritare KOHA në kuadër të angazhimit për Draftimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal 2015-2016 (PVRL). Hulumtimi bëhet në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Kulturë, Rini e Sport dhe me mbështetjen financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe qëllim të vetëm ka PASQYRIMIN E GJENDJES SË RINISË DHE NEVOJAVE TË SAJA NË KLINË.

Të dhënat janë konfidenciale dhe përdoren vetëm për nevoja të PLVR-së dhe zhvillimeve pozitive për rini.

Ju lutem, që përgjigjet në pyetjet e mëposhtme të janë reale dhe të pasqyrojnë realitetin sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i gasemi nevojave të rinisë dhe t'i adresojmë këto cështje përmes PLVR-së.

1. Keni njohuri mbi Ligjin për Rini? PO JO
Nëse PO, çfarë dini për këtë Ligj: _____

2. Dini për ekzistencën e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal dhe Qendren Rinore dhe rolin e tyre
PO JO

Nëse PO çfarë dini:

OJQ KOHA

Rr. 'Abedin Rexha' pa nr.

Klinë

32000

Email: ojq.koha@gmail.com



Organizata Jo Qeveritare

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Departamenti i Rinisë

Municipality of Klinë-Opština Klinë

3. Jeni konsultuar ndonjëherë nga Komuna e Klinës për çështje rimore? PO JO

Nëse PO, për çfarë temash:

4. Dini për ekzistimin e edukimit joformal? PO JO

Nëse PO, spjegoni çka përbën:

5. A jeni pjesë e ndonjë grupi shoqëror? (Shëno dhe specifiko në cilën bën pjesë)

- a. Sport _____
- b. Kulturë _____
- c. Rekreacion _____
- d. Vullnetarizëm _____

6. A ka kushte (infrastrukturë) për zhvillimin e aktiviteteve për rini? PO JO

Nëse JO, çfarë do të

propozonit:

7. Cfarë duhet të bëjë Komuna e Klinës për rinin e Klinës? (Shkruaj cfarë mendon)

8. Keni informacione mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme (Aids, gonorrea ose blenorragjia, herpesi gjenital, hepatiti B, etj.)? PO JO

- 8.1. Keni marrë pjesë në ndonjë ligjeratë edukative? PO JO

9. Keni provuar ndonjëherë njëren nga këto (shënjoni katrorin)?

Duhan PO JO Alkool PO JO Drogë PO JO

10. A ndjeheni të sigurt në rrugë, shkollë, qytet/fshat? PO JO



11. Çfarë synoni pas përfundimit të shkollës së mesme?

Punë: PO JO

Studime: PO JO

Dalje jashtë shtetit: PO JO

12. Dini për të drejtat që të rinjve ju garanton Ligji? PO JO

Organizata Jo Qeveritare KOHA është themeluar me qëllim që: Të kontribuoj se të mirë të shoqërisë së sotë, duke u marrur me organizime të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetarët e vendit; Synim do të jetë të qenurit një shoqëri aktive - qytetarë aktiv (viv' aktiv); të vendlidjetëm të qytetarëve për detyrat, obligimet, por edhe të drejtat e shumta që i lejohet ligjet e rregullorët në fushë; të promovimit të demokracisë dhe muglat drjet integrimeve; rritja e vendlidjes qytetare; pjesëmaraja e qytetarëve në vendimtarje, po ashtu që ohrrin e pustifikat se më së shtunë; të kontribuoj në lusjen e arsimit, kulturës e rinisë, ambientit, angazhohet për qytetarë aktivë si dhe zhvillim të kulturës së debatit; OJQ KOHA është e hapur për çdo bashkëpunim në të mirë të vendit dhe qytetarit.

Draft PLVR 2015-2016 është punuar nga Organizata Joqeveritare KOHA, përkatësisht:

Labinot Krasniqi, Drejtor Ekzekutiv;
Elbasan Racaj, Kordinator i Projekteve dhe;

Asistent
Adnan Bekaj, Përgjegjës i Financave; dhe
Agron Gashi, Asistent i Projekteve

50 kurje